

Ndryshimi, forma natyrale e mbijetesës. Si, përse, çfarë dhe kur duhet të ndryshojmë nëse duam të mbijetojmë.

Nga eksperiencia ime shoh që ndryshimi, dëshira për të ndryshuar si vehten dhe tjetrin (duke filluar nga vetja) ka qënë gjithmonë e madhe. Kjo mbase zhvillimi im profesional ne perëndim e përkrah ndryshimin dhe e shohin ndryshimin si të bësh të njëjtën gjë por në mënyrë më efikase. Pse jo dhe të krijosh diçka të re, nje nevojë të re për njerëzimin e cila kërkon gjithashtu një ndryshim personal.

Ja pra, të nderuar zonja dhe zotërinj çfarë do të thotë të ndryshon në të vërtetë. Disa mendojnë që të ndryshosh do të thotë të bëhesh dikush tjetër, të ndryshosh do të thotë të bësh diçka që stë pëlqen, të ndryshosh do të thotë të imponohesh, të ndryshosh do të thotë të imponojnë.

Historia na tregon, duke marrë si bazë liderin e fundit të SHBA-së Presidentin e 44 Barack Obama; Change, yes we can! Me slloganin e tij bëri të ndryshojë një shtet të tërë, mund të themi dhe globin. Ka dhe kritikues, gjithmonë ka kritikues, por faktet tregojnë që SHBA-ja ishte jo në gjëndje të mirë dhe tani, duke mos përmëndur shifra, ka një rritje eksponenciale.

Po të shohim sinonime të fjales ndryshoj gjejmë këto fjale:

Ndërrim, këmbim, turn, shkëmbim, këmbej, ndreq, pësoj, ndryshim, ndërroj, drejtim, rregullim, avancoj, zhvillim, diversitet, risi, modifikim, rishikim, revolucion, transformim, tranzicion, kthej shpinën, shtim, pushim, ngjeshje, tkurrje, konvertimit, korrigjim, shtrembërim, diversifikimi, metamorfozë, ulje, mutacion, risi, ndërrim, rindërtim, sqimë, remodeling, zëvendësues, kalitje, shndërrim, kthesë, qarkullim, grindje, shumëllojshmëri, peripeci.

Eksperiencia na tregon se ariu i murme u bë ari bardhë, pra ndryshoj për mbijetim. Zogjtë e galapagos zhvilluan sqepa më të fortë në krahasim me familjarët e tyre. Fluturat me ngjyra u kthyen

ne flutura të zeza që të mimetizoheshin me ambientin (nga ndotja pemët vishen me smog). Gjirafat janë antilopa që kanë zgjatur qafën. Do thotë dikush ky është evolucion! Të evolosh do të thotë të ndryshosh të mbijetosh.

Në natyre, si ajo moderne që është qytetërimi i sotshëm deri tek pylli, shkretëtira, mali, deti, etj, po nuk ndryshove, po nuk u përshtate për mbijetesë do vdesësh. Në cilën do vënd që të jesh ti o të sulmojnë, natyra si dhe njerezit e tjere, ose sulmon. Jeta është e tillë. Dikush më i fortë dhe dikush më i dobët. Mos më keqkuptoni. Ne kemi dekada mos them shekuj që jemi largë, sado në teori në një aspekt, sulmit njeriu ndaj njeriut për mbijetesë. Njeriu modern, ka ulur ndjeshëm testosteronin dhe tani me anë të komunikimit, pjesa më e rëndësishme e njeriut si dhe njesia me të cilin ne na ndihmon të evoluojmë sporiadikisht, bashkëpunon për mbijetesë. Hajde e bëjmë kështu, si mendon ta ndryshojmë për më mirë, çfarë kontibuti do japësh ti për të ndryshuar vehten, komuniteti dhe pse jo botën, është forma e re e ndryshimit.

Mos e merrni ndryshimin sikur dikush ju sulmon, sikur dikush ju do të keqen, e kuptoj gjëja e re është e vështirë për tu përtypur, por po i vure fatke, argumenta të forta për bazë, ndryshimi do jetë i mirëpritur. Le të marrim një shëmbull duke ju treguar çfarë më ndodhi kto ditë.

Ishim në një restaurant të ri. Vendosa të provoja diçka të re që ma sygjeroj shefi i guzhinës. E keni vënë re kur porosisni diçka të re për të ngrënë. E porosini me druajtje. Vjen pjata përpara jush, e shikoni dhe që në ato momente fillon sistemi autopilot. Mbrojtja ndaj asaj që keni dhe dini. Por po të ishit në rrast rreziku dhe disa ditë pa ngrënë do e hanit pa ja vën shumë veshin çfarë është. Duke testuar pjatën ju ulni barrieren autopilotë. E keni vënë re që e nuhasni në fillim, për ta katergorizuar me diçka që njihni. Fusni lugën për ti parë konsistencën a e ka me ndonjë gjë njihni. Merrni pak fare me lugë për ta provuar. Pasi e përtypni në gojë dhe pasi tju ketë shijuar bulzave të gjuhës, ose jo, e kapërdini. Ju pëlqen

vazhdoni ta hani. Sju pëlqen merrni tjetër. Kjo është dhe jeta shijime, përtypje të vogla deri sa të marrim një informacion dhe të krijojmë një informacion të ri mbi diçka të re.

E njëjtja ndodh me punën, nëse je punonjës apo punëdhënës. Duhet të ndryshosh që firma të mbijetojë ose duhet të ndryshosh që ti të marrësh rrogën. E njëjtja ndodh në dashuri, nëse je vajza apo djali. Duhet të ndryshosh që të dojë pala tjetër. E njëjtja në shoqëri, në familje, etj. Pa ndryshim mbetesh vetëm, sdo njeri të punoj, bashkëpunoj me ty. Sepse ti dhe çdo gjë tjetër ecën përpara, po mendove që rri në vënd gabohesh. Ti shkon vetëm mbrapa po nuk ndryshove.

Do thotë dikush pse të ndryshoj për shokun, për shoqen, të dashuren ose të dashurin. Ti njihesh me dikë? E takove sot e zëjmë. Ti je shumë mirë siç je sot. Por po ecëm bashkë dhe vazhdojmë të takohemi, frekuentoheni, smund të rrish siç je. Gënjen vehten ashtu. Se ti sot je 15vjeç, mbas 10 vitesh je 25 vjeç. Unë kam kërkesa ti ke kërkesa. E kupton ndryshimin tani?

Eksperienca tregon, një njeri i fortë, lider merr një vendim dhe nuk e ndryshon rrugëtimin, ndërsa një njeri i dobët merr disa vendime dhe ndryshon gjithmonë ato përgjatë rrugëtimit. Kush ndryshon, ndërton; kush ndërton, ecën përpara. Po mos të ndryshonim, do të mbeteshim akoma nëpër shpella, do hanim mish të pabërë, nuk do ishim kush jemi. Ata që ëndërrojnë të ndryshojnë, ëndërrojnë të jetojnë përgjithmonë. Ata që ndryshojnë, jetojnë përjetë.

Per ta mbyllur po ju tregoj per 3 tipe njerëzish. Ose më saktë njeriu nëse e kupton kalon në tri faza jete. Faza e para ose personi i parë do të bëjë vetëm qejf. Nëse ndriçohet, ai kalon në etapën e dytë. Të punojë mbi bazën e gjërave që kanë lënë të tjerët. Por po e kaloi dhe këtë etapë, duke menduar sesi ta ndryshojë etapën e dytë, duke hyrë në etapën e tretë vetvetiu, atëherë ai bëhet njeriu që krijon.

Zgjidh te ndryshosh.

Elvis Ponari 18.8.2015 Tirana